

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Punime primare, furnizim dhe vendosje e një autotransformatori të ri 410√3/230√3 kV, 115 MVA njëfazor, punime sekondare për përshtatjen e tij me sistemet ekzistuese në nëstacionin Koman”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45317200-4 - Instalime elektrike të transformatorëve.

VLERA E FONDIT LIMIT:

299,369,500 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 299,000,000 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë milion) Lekë.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë e mallrave dhe punimet objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros duhet të jete në masën 299,000,000 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë milion) Lekë..

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet të ketë realizuar të paktën:*

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 140,000,000 (njëqind e dyzet milion) lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se 590,000,000 (pesëqind e nëntëdhjetë milion) lekë.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shenim: Kontrata të ngjashme persa i përket punimeve elektrike për vete specifiken që kanë, do të konsiderohen punimet në Nënstacionet elektrike me nivel tensioni ≥ 400 kV.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, dhe nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, punimet e kerkuara dhe natyren specifike te kesaj kontrate, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete sipas parashikimeve ligjore. Ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

Përsa i përket cilësimit të kontratave të ngjashme, sipas opinionit teknik të inxhinierëve të AK gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, sqarojmë se Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. administron rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike me tension 110-400 kV, që përbëhet nga nënstationet 400/220 kV, nënstatione 110/TM kV dhe linjat 110/220/400 kV.

Për të garantuar funksionimin normal dhe të sigurtë të sistemit elektro-energjetik, OST sh.a. ka për detyrë zhvillimin, automatizimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen e komponentëve të Sistemit të Transmetimit.

Theksojmë se, OST sh.a. është institucioni i vetëm menaxhues i objekteve me këto nivele tensioni.

Garantimi i qëndrueshmërisë të Sistemit Energjetik si dhe siguria e furnizimit me energji elektrike në tensionet e larta bazohet në zbatimin e rreptë të rregulloreve të Sigurimit Teknik dhe të Shfrytëzimit Teknik të Nënstationeve dhe Linjave të Sistemit Energjetik.

Për të bërë një krahasim të nivelit teknik/profesional të kërkuar në punimet në pajisjet e tensionit të lartë argumentojmë si vijon:

- Rrjetet e administruar nga OST sh.a. janë të ndërtuar në ajër (AIS) pra, përdorin qëndrueshmerinë elektrike të ajrit si material izolues. Ato kërkojnë sipërfaqe të madhe dhe në

shumë raste punime në hapësira që janë afër pajisjeve nën tension të lartë që paraqesin rrezikshmëri të lartë për operatorët. Puna e tyre mbikëqyret dhe kushtëzohet nga kërkesat e rregulloreve të sipërpërmendura. Në nënstacion/linja mund të punojnë vetëm operatorë të instruktuar dhe me kartelë të sigurimit teknik.

- Pajisjet primare vendosen në bazamente betoni të armuar dhe konstruksione mekanike të veçanta. Theksojmë që pajisjet primare janë të rënda dhe njëkohësisht tepër delikate. Ato kërkojnë makina ngritese/transportuese si dhe rrespektimin e rregullave të veçanta për transportin, lëvizjen, vendosjen në bazament dhe montimin.
- Punimet për kabllimin, testimin, komisionimin e tyre, të cilat kryhen për secilin element kanë nevojë për operatorë shumë të specializuar për shkak të vështirësive, kompleksitetit të punimeve dhe kanë një kosto relativisht të madhe.
- Mbrojtja rele është një pajisje komplekse që shfrytëzon të dhëna të kombinuara (rryme/tension) dhe mbrojtje rryme, të cilat kabllohen duke krijuar llogjika për bllokime elektrike për mosveprim në rast veprimesh të gabuara. Mbrojtjet rele dhe automatika (BCU) vendosen në panele të veçanta.
- Për testimin dhe komisionimin e saj ndiqet një procedurë e standardizuar IEC. Kompleksiteti i punës në to kërkon gjithashtu punonjës me specializim të lartë dhe njohuri të thella për pajisjet.
- Matja vendoset në panele të veçantë dhe ndiqet një procedurë e standardizuar testimi që është e rregulluar nga norma të rrepta IEC. Operatorët janë tepër të specializuar.
- Në një nënstacion bëhen punime për SKADEN dhe Telekomunikacionin që kërkojnë njohje të pajisjeve dhe specializim të lartë të operatorëve dhe kompanive që punojnë.
- Punimet për ndërtimin/rikonstruksionin/punimet e linjave të tensionit të lartë/nenstacionet kanë vështirësi që lidhen me projektimin, ndërtimin, vendosjen e shtyllave, përcjellësve dhe elementeve të ndryshëm përbërës të saj. Ndërtimi i një linje të tensionit të lartë kërkon makina dhe pajisje speciale pa të cilat kompromentohet seriozisht cilësia e punimeve për ndërtimin e tyre. Ndërtimi i linjave të tensionit të lartë kërkon kushte teknike të veçanta dhe shumë të rrepta pasi ato ju nënshtrohen kushteve atmosferike tepër të rënda dhe duhet të paraqesin qëndrueshmëri të mjaftueshme mekanike ndaj tyre.
- Mund të pohojmë se, kompleksiteti, vështirësia dhe rëndësia e punimeve të sipërpërmendura rritet me rritjen e nivelit të tensionit (ndryshimi mes 400 kV dhe niveleve të tjera më të ulëta të tensionit) dhe përcakton në mënyrë domethënëse edhe kërkesat për nivelin profesional të operatorëve që do të kryejnë ato si dhe përdorimin e makinave dhe pajisjeve.

Theksojmë se: në përcaktimin e kushteve për punime në objektet e OST sh.a., përveç rregulloreve tona, është marrë si model edhe procedura dhe kërkesat teknike të ndjekura nga Kontraktorë të huaj shumë të njohur dhe me eksperiencë që kanë punuar në objektet tona prej më shumë se 15 vite.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizim prodhuesi/distributori te autorizuar per mallrat objekt prokurimi sipas pershkrimit te specifikimeve teknike: **Transformatorin e fuqise 115 MVA, 410/230 kV; Variatorin e ndryshimit te degezimeve ne ngarkese (sipas Specifikimeve Teknike).** Autorizimi duhet te permbaje te dhenat e plota si: Nr. telefoni, fax, e-mail, website te dhena keto qe do ti sherbejne autoritetit kontraktor ne rast verifikimi.*

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave, si dhe shërbimeve në lidhje me to. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jodiskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete minimumi 5 (pese) punonjes, te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik, nga te cilet 3 (tre) te jene punonjes me kategorine e sigurimit teknik IV-V, te leshuar nga shoqeri te akredituara ne baze te Ligjit Nr. 8734, date 01.02.2001 “Per garantimin e sigurise se punes te pajisjeve dhe te instalimeve elektrike”, i ndryshuar.*

Lidhur me kete pike, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje:

- i. Listpagesat E-Sig te punonjesve te siperctuar, si dhe*
- ii. Kartelat perkatese te vlefshme te sigurimit teknik.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për personelin e pajisur me kartelat e sigurimit teknik, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kartelat përkatëse të punonjësve që do të kryejnë punimet objekt kontrate. Një numer i tillë të siguruarish është kërkuar pasi punimet objekt procedure prokurimi kërkojnë punonjës të kualifikuar dhe të aftë, që të punojnë sipas kërkesave të sigurisë në punë për të shmangur rrezikun për jetën, shëndetin dhe çdo problem tjetër, gjatë zbatimit të kontratës.

Punonjesit qe do te realizojne kete kontrate, per arsye te natyres teknike te saj dhe kushteve te punes ne linjat e tensionit te larte, duhet te respektojne rregulloren e sigurimit teknik elektrik,

bazuar ne dispozitat ligjore perkatase per punimet mbi 1000 Volt, ne lartesi, me heqje dhe pa heqje tensioni, duke repsektuar largesine me tensionin nominal te punes per linjat.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar si drejtues teknik te perfshire ne licencen e shoqerise te pakten 1 (nje) inxhinier mekanik, 1 (nje) inxhinier elektrik dhe 1(nje) inxhinier elektronik. Inxhinieret e mesiperm duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatase E-Sig per 12 (dymbedhjete) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates. Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat perkatase te inxhinierëve te mesiperm, si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me inxhinieret e kerkuar, argumentohet se keto profile teknike inxhinieresh jane ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne Specifikimet Teknike dhe Preventivin e punimeve objekt procedure prokurimi, si dhe natyrën dhe vlerën e kontratës, është proporcional dhe i lidhur me aftësinë zbatuese, me qëllim realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës. Keto profile inxhinieresh i japin sigurine AK qe kjo kontrate do te realizohet nga OE ofertues pa patur vonesa dhe probleme te tjera. Punimet objekt procedure prokurimi do te realizohen ne perputhje me stakimet e nevojshme te energjise elektrike dhe AK duhet te marre masat e nevojshme qe keto stakime te jene sa me te shkurta, ne menyre qe te vijohet ecuria e veprimtarise se saj.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete numrin e nevojshem te punonjesve per realizimin dhe zbatimin e kontrates. Numri i punonjesve te siguruar duhet te jete jo me pak se 10 (dhjete) punonjes per 12 (dymbedhjete) muajt e fundit, nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje listepagesat perkatase E-Sig. Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me numrin e fuqisë mesatare punëtore të siguruar, duke patur parasysh volumet e punëve objekt kontrate, natyrën dhe vlerën e kontratës, ky numër punonjësish është proporcional dhe i lidhur me aftësinë zbatuese, me qëllim realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës. Numri i punonjësve është perlllogaritur duke patur në konsideratë shtrirjen gjeografike të shtyllave objekt punimi, si dhe volumin e punës për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, si dhe pika 6/ç, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.6 *Operatori ekonomik (në bazë të Ligjit 10237 dt.18.02.2010, neni 5, pika 15) për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier) duhet të ketë të pakten 1(një) inxhinier të trajnuar dhe të pajisur me certifikatë si përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë me rrisht të lartë, i cili të jetë i siguruar të pakten për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe duhet të jetë prezent në kantier gjatë ekzekutimit të punimeve, Certifikata të jetë e leshuar nga shoqëri të licensuara nga ministria përkatëse.*

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë diplomën përkatëse, certifikatën e inxhinierit, lincencën e shoqërisë e cila ka trajnuar punonjës të OE, si dhe listepagesat përkatëse E-Sig.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Përsa i përket kërkesës për një inxhinier të trajnuar dhe të pajisur me certifikatë si përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë me rrisht të lartë, argumentohet se është i nevojshëm të qendrohet në kantierin e punimeve për të ndjekur ecurinë e punës së punonjësve të OE ofertues dhe të jetë i gatshëm në rastin e paraqitjes së kushteve të rrezikshme që mund të ndodhin gjatë zbatimit të kontratës objekt prokurimi, në përputhje me Ligjin Nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.7 *Ofertuesi duhet te disponoje minimalisht mjetet e meposhtme per kryerjen e punimeve, me qellim realizimin e objektit te prokurimit:*

<i>Nr.</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Autovinc me kapacitet jo me te vogel se 150 ton</i>	<i>1 cope</i>

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike operatori duhet te disponoje:

- 1. Per mjetet, makinerite dhe pajisjet ne pronesi te paraqitet akti i pronesisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit).*
- 2. Per mjetet, makinerite dhe pajisjet me qira të paraqitet kontratë qiraje si dhe akti i pronesisë së qiradhënësit sipas percaktimit te bere me lart.*
- 3. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi) dhe akti i kolaudimi.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Mjetet e vendosura si kërkesë për tu plotësuar nga OE, janë të domosdoshme për punimet gjate realizimit te kontrates objekt procedure prokurimi, për realizimin e punimeve që do të kryhen në kantier. Kjo kërkesë është minimale dhe jodiskriminuese në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, si dhe pika 6/d, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.8 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve, te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, qe kane lidhje me objektin e prokurimit, si me poshte:*

- ✓ ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë.*
- ✓ ISO 14001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit.*
- ✓ ISO 45001: për Sistemin e menaxhimit të sigurise ne pune.*

Argumentimi: Ne lidhje me kërkesën qe OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me to, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare, të objektit të kontratës.

Certifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise ISO 9001: eshte sot referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ISO 14001: e kërkuar nga AK garanton se OE ofertues është i certifikuar për produkte të cilat nuk demtojnë mjedisin dhe nuk e ndotin atë dhe që janë konform standardeve ndërkombëtare të cilësisë.

Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001: është vendosur si kriter kualifikues për operatorët ekonomik ofertues sepse ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila është me një rëndësi të vecantë për kryerjen e kësaj kontrate. OE ofertues që do të realizojë kontratën objekt procedure prokurimi duhet të kryejë punimet objekt procedure prokurimi dhe kjo kategori licence minimizon rreziqet që mund të shfaqen gjatë realizimit të kësaj kontrate.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024 dhe nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.9 *Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licence profesionale në fushën e projektimit ose të ketë marrveshje kontraktuale me disponuesit e këtyre licencave, leshuar nga organet përkatëse, e cila të përmbajë kategorinë e mëposhtme:*

Projektim impianteve të shpërnd. en. elektrike - Pika 10/ d

Argumentimi: Kjo kategori projektimi është në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe objektin e prokurimit, është proporcionale dhe e lidhur ngushtë me realizimin e punimeve, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, si dhe pika 6, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu, OE ofertues mund të kontraktonte disponuesin e kësaj kategorie licence, nëse nuk e disponon, me qëllim realizimin e kontratës.

2.3.10 *Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licence profesionale, në fushën e zbatimit të punimeve, leshuar nga organet përkatëse, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:*

Punime të përgjithshme:

Kategoria <u>NP-11</u>	Ndertime për nënstacionet, kabinetat e transformatoreve, linjat TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	Klasifikimi E
------------------------	---	---------------

Shënim: *Ne rast pjesëmarrjeje të një Operatori ekonomik të huaj, ky i fundit, Licencën e mesipërme me kategoritë e përkrahura, duhet ta ketë të njohuar pranë organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit të saj në fuqi.*

Argumentimi: Kjo kategori punimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin

77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, si dhe pika 6/a, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit ose fragmente të katalogut për mallrat objekt prokurimi, pjesa që i perket të dhenave teknike të jete e perkthyer në gjuhën shqipe. Katalogu/Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qarte që janë pjesë të katalogut, si dhe cilin katalog dhe cilin prodhues i perkasin.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.12 Testimet sipas specifikimeve teknike të kërkuara, duhet të behen në prani të përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktor, në përputhje me standartet e dhena në Specifikimet teknike. Për këtë qëllim operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që merr përsipër shpenzimet si dhe siguron lehtësirat e dhura për 3 (tre) specialiste të Autoritetit Kontraktor për të marrë pjesë në këto teste pranë prodhuesit.

Argumentimi: Sipas kërkesës së specifikimeve teknike, OE ofertues duhet të mbulojë të gjithë shpenzimet e nevojshme për të bërë testimet e kërkuara në prani të përfaqësuesve të AK.

Ky kriter është në përputhje me nenin 39, pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.13 Operatori Ekonomik ofertues duhet të plotësojë kolonën e të dhenave teknike në tabelën perkatëse në Shtojcën 5: Tabela për të dhenat Teknike të transformatorit të fuqisë 115 MVA, 410/230 kV. Tabela e plotësuar me të dhenat teknike duhet të jetë e konfirmuar (nenshkruar) nga prodhuesi.

Mos plotësimi i kësaj table perben element skualifikues.

Argumentimi: Plotësimi i këtij kriteri është vendosur në vijim të përcaktimeve të Nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara. Kjo e garanton AK-në se ofertuesi e njëjshëm konkretisht produktin e kërkuar dhe merr përsipër paraqitjen e tij pa asnjë devijim nga sa kërkohet në DT. Ky kriter është vendosur bazuar në rëndësinë e veçantë që këto pajisje kanë në procedurën objekt prokurimi, është në proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës.

2.3.14 *Meqenese objekti i kontrates permban demontimin e sistemeve te TMS –ve (BMT+DGA) nga Transformatori i demtuar, instalimi i ketyre sistemeve ne Transformatorin e ri si dhe integrimi i tyre sistemeve ne ate ekzistues, atehere operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij, te pakten nje specialist te certifikuar per instalimin dhe komisionimin e ketyre sistemeve. Ne rast se OE ofertues nuk e disponon kete specialist, atehere duhet te kete nje marrveshje kontraktuale me specialistin e kerkuar.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje certifikaten e specialistit, listepagesat perkatese E-Sig / marreveshje kontraktuale me specialistin e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për punonjesin e sipërcituar është në përpjestim dhe e lidhur me objektin e kontratës, respekton edhe parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë minimale e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e vet tregëtar keto lloj niveli punimesh. Keto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me pikën 6, të Nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.15 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per punimet objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e

duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" i ndryshuar.